

# Jeta buron nga fshati

## Parlamenti i tretë Rural Shqiptar 2023

11-13 TETOR 2023

NË AMBIENTET E UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS

Organizuar nga: Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural  
në bashkëpunim me 34 organizatat e veta anëtare  
dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës

## PROGRAMI



Realizuar me mbështetjen e:



Implemented by




ITALIAN AGENCY  
FOR DEVELOPMENT  
COOPERATION



Food and Agriculture  
Organization of the  
United Nations

"Ky publikim u bë i mundur me mbështetjen financiare të  
Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë të Kombeve të Bashkuara (FAO)."



*Jeta burore nga fshati*

**Parlamenti i tretë Rural Shqiptar 2023**

**PARLAMENTI I 3-të RURAL SHQIPTAR** – një platformë kombëtare kushtuar ngritjes së kapaciteteve, rrjetëzimit dhe advokacisë për zhvillim të qëndrueshëm rural – zhvillohet në ambientet e Universitetit Bujqësor të Tiranës, nga data 11 deri më 13 tetor 2023. Parlamenti i 3-të Rural i Shqipërisë përfaqëson një përpjekje bashkëpunimi midis Rrjetit Shqiptar për Zhvillim Rural (ANRD) dhe 34 OSHC-ve të veta anëtare, në partneritet me Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT).

Parlamenti kombëtar rural përfaqëson përpjekjen më të qëndrueshme të advokacisë nga poshtë-lart, duke krijuar hapësirë për dialog dhe bashkëpunim, shkëmbim të këndvështrimeve rreth çështjeve të rëndësishme dhe aktuale të zhvillimit rural dhe bujqësor, si dhe për të ofruar rekomandime për gjallërimin e jetës dhe ekonomisë rurale. Platforma e këtij edicioni të tretë do të ofrojë mënyra novatore dhe qasje të reja për të arritur një konsensus të gjerë mbi prioritetet e zhvillimit rural në nivel kombëtar. Platforma synon të forcojë zërin e sektorit civil dhe privat në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm rural.

Parlamenti i tretë vjen me një platformë të plotësuar, duke krijuar për herë të parë mundësi për të rinjtë nga zonat rurale, fermerët e rinj dhe sipërmarrësit të mblidhen në Asamblenë e tyre Rinore: “me të rinjtë, për të rinjtë, nga vetë të rinjtë e Qendrës së Rinisë Rurale të ANRD-së”. Gjithashtu, Edicioni i 5-të i Pro-Grave rurale 2023 do të organizohet në kuadër të Parlamentit Rural për të fuqizuar advokacinë për një sektor bujqësor dhe rural, për komunitetet dhe një shoqëri me mundësi të barabarta për të gjithë.

Tema e Parlamentit të 3-të Rural Shqiptar - **JETA BURON NGA FSHATI** – përgatit terrenin për dialog dhe bashkëpunim konkret, për të analizuar realitetin dhe për t'u njohur më mirë me nevojat dhe problemet, për të reflektuar mbi vizionin dhe prioritetet si veprime kolektive me qëllimin final për të fuqizuar dhe përmirësuar cilësinë e jetës në komunitetet rurale në të gjithë vendin.

“Jeta buron nga fshati” shërben si një thirrje e fuqishme për veprim drejt nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm rural. Kjo temë thekson të vërtetën e madhe se zhvillimi dhe përparimi i Shqipërisë vjen nga zonat e saj rurale. “Jeta buron nga fshati” thekson rëndësinë e mbështetjes së ekonomive rurale, investimit në infrastrukturë dhe arsim dhe krijimit të mundësive për të rinjtë brenda komuniteteve të tyre. Tema na nxit të rivlerësojmë rëndësinë e komuniteteve rurale dhe ekonomisë së tyre në kontekstin e sfidave aktuale, duke përfshirë ndryshimet klimatike, migrimin nga zonat rurale etj.

# Reflektim mbi rrugëtimin deri në parlamentin e tretë rural të vendit

Kanë kaluar tashmë gati tetë vite që nga themelimi i Rrjetit Kombëtar për Zhvillimin Rural, me synim promovimin e qasjes LEADER në vendin tonë duke u fokusuar në mbështetjen dhe ngritjen e kapaciteteve të aktorëve publik dhe privat në zonat rurale, në ndërtimin e partneriteteve në funksion të ngritjes së Grupeve Vendore të Veprimit (GVV), si edhe në rritjen e besimit të shoqërisë rurale për të ecur në rrjedhën e politikave dhe praktikave evropiane të zhvillimit të qëndrueshëm.

Njëherazi, ANRD ka mbështetur advokimin kombëtar për politika mbështetëse dhe inkurajuese për zhvillimin e qasjes LEADER, por edhe politika dhe skema financiare mbështetëse për fermerët dhe aktorët e tjerë të angazhuar, për të sjellë besim dhe nxitur aktivizimin e tyre në këtë rrugë. Mbështetja e kapitalit social ka qenë dhe mbetet prioritet për ANRD-në.

Parlamenti rural shqiptar është një përpjekje edhe më e fokusuar në drejtim të fuqizimit të grupeve të rëndësishme shoqërore, dhe pikërisht ngrihet mbi dy shtylla të rëndësishme për jetën rurale dhe qasjen LEADER, atë të Qendrës së Rinisë Rurale dhe mbështetjen e nismës së Pro-Grave Rurale.

Parlamenti i tretë rural në vend vjen në një kohë, që falë edhe advokacisë nga poshtë, kur Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin për Grupet Vendore të Veprimit duke krijuar një mundësi reale për të zhvilluar partneritete për fuqizimin e bashkëpunimeve vendore për zhvillimin e qëndrueshëm rural.

Por, përgatitja e aktorëve vendorë, njësisive të vet-qeverisjes vendore, biznesit dhe shoqërisë civile ende është larg një investimi të qëndrueshëm për të rritur besimin e aktorëve për t'u bërë bashkë për ndryshim. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural duhet të bëjë më tepër për të hapur proceset ndaj aktorëve të shoqërisë dhe të rrisë këtë bashkëpunim. Mbështetja e fermerëve apo sipërmarrjeve turistike rurale duhet të shoqërohet me ndërgjegjësimin e komuniteteve vendore duke i vlerësuar, le të themi "bujtinat" si instrument cilësor për fuqizimin e Grupeve Vendore të Veprimit të zonës. Kjo kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm, duke qenë se është investim në kapitalin njerëzor.

ANRD vjen në këtë ngjarje kombëtare më e konsoliduar, me një trend rritës të anëtarësisë dhe një aktivitet që kalon kufinj të vendit. Rrjeti është i shtrirë në të gjithë vendin, dhe ka raporte bashkëpunimi me të gjithë njësitë e vet-qeverisjes vendore. Synim në vazhdimësi mbetet konsolidimi i Rrjetit Kombëtar për Zhvillimin Rural si qendër burimore për zhvillimin e qëndrueshëm rural të vendit dhe zbatimin e qasjes LEADER.

Me kënaqësi evidentojmë se ANRD ka rritur praninë e saj në shumë organizata dhe aktivitete evropiane. Njëkohësisht është vlerësuar me çmime të ndryshme, një ndër të cilët është Flamuri i Gjelbër (Green Flag) CIA Agricoltori Italiani, duke dëshmuar punën e vet të bërë ndër vite në sektorin e fuqizimit të shoqërisë civile dhe zhvillimit rural në Shqipëri.

Rrjeti tashmë është tërësisht i pavarur sa i takon anës administrative dhe udhëheq projekte rajonale të financuara nga BE dhe jo vetëm.

Rrjeti Kombëtar për Zhvillimin Rural është duke zgjeruar dhe bashkëpunon edhe me institucionet publike në vend. Krahas bashkëpunimit shumë të mirë me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, është rritur komunikimi edhe me Komisionin Parlamentar të Veprimtarisë Prodhuese, një ngjarje shumë e rëndësishme për impaktin e punës së Rrjetit.

Univesiteti Bujqësor i Tiranës mbetet partneri ynë kryesor, jo thjesht për hapësirë fizike të mjediseve të tij që si gjithmonë ndahen me dashamirësi, por edhe për mbështetjen dhe këshillimin e vazhdueshëm në punën tonë.

Në përfundim, më lejoni të falenderoj të gjithë donatorët që kanë mbështetur Rrjetin Kombëtar për Zhvillimin Rural në këto vite, bashkëpunëtorët tanë kudo në vend, dhe të gjithë pjesëmarrësit në këtë aktivitet të përbashkët dhe të rëndësishëm për të gjithë.

**Sotiraq Hroni**

**Kryetar Bordi**

**Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural**

# DEKLARATË

*Asambleja e Përgjithshme e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural, mbledhur më 7 prill 2023*

Ne, tridhjetë e katër organizatat anëtare të Asamblesë së Përgjithshme të Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural, mbledhur më 7 prill 2023, kemi kënaqësinë të njoftojmë fillimin e përgatitjeve për Parlamentin e tretë Kombëtar Rural për t'u organizuar në datat 11-13 tetor 2023.

Parlamenti kombëtar rural synon të sjellë së bashku një spektër të gjerë të aktorëve të interesit, duke përfshirë komunitetet vendore, organizatat lokale, sektorin privat dhe politikëbërësit, 61 bashkitë e vendit për të diskutuar mbi sfidat dhe mundësitë me të cilat përballet zhvillimi rural në komunitetet tona. Parlamenti i tretë rural shqiptar përputhet plotësisht me vizionin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural dhe Peshkimin 2021- 2027 dhe veçanërisht me Politikën 1- zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë dhe zonave rurale, dhe objektivin e tretë të përgjithshëm të kësaj politike.

Platforma e parlamentit rural vë në dukje disa specifika të tjera të rëndësishme të këtij objekti: Forcimi i strukturës (ekologjike), sociale dhe ekonomike të zonave rurale. *Promovimi i zhvillimit lokal nëpërmjet (përmirësimit të jetesës në zona të thella dhe malore dhe integritit në mënyrë të përshtatshme të komuniteteve vendore, mbështetjes për zhvillimin e pastoralizmit ekstensiv), mundësive punësimit dhe të zhvillimit të biznesit brenda dhe jashtë fermës bujqësore (dhe blegtorale), si dhe përmes iniciativave të udhëhequra nga komuniteti.*

**Kjo platformë në këtë edicion të tretë do ofrojë mënyra novatore dhe qasje të reja për të arritur konsensus të gjerë mbi prioritetet e zhvillimit rural në nivel kombëtar, të cilat lidhen në nivele më të larta si dhe për të forcuar zërin e sektorit civil dhe privat në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm rural.**

*Ne jemi të bindur se zhvillimi rural është thelbësor për arritjen e rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, dhe përmirësimin e jetesës së popullsisë rurale. Megjithatë, zhvillimi rural përballet me sfida të shumta, duke përfshirë varfërinë, aksesin e kufizuar në shërbimet bazë, mungesën e infrastrukturës dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike. Për më tepër, turizmi masiv që nuk respekton jetën kulturore dhe stilin e jetesës së popullsisë vendase nuk po ofron energjinë e duhur për zhvillimin e qëndrueshëm rural.*

*Ne besojmë se kjo platformë do të jetë një mundësi për të shkëmbyer përvoja, njohuri dhe ide se si mund t'i kapërcejmë këto sfida dhe të promovojmë*

zhvillimin e qëndrueshëm rural. Duke bërë bashkë palët e interesit ne shpresojmë të nxisim partneritetet dhe bashkëpunimet që do të na mundësojnë të zhvillojmë dhe zbatojmë zgjidhje novatore dhe lokale për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm rural.

*Ne angazhohemi të punojmë së bashku për të krijuar një Parlament gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës, ku zërat dhe perspektivat e të gjithë aktorëve, dhe në veçanti e grupeve të cenueshme, dëgjohen dhe merren në konsideratë.*

*Ne synojmë të mbajmë të qëndrueshme këtë platformë për dialog dhe shkëmbimin e praktikave më të mira dhe të mësuarit nga përvojat e njëritjetrit, për të zhvilluar propozime konkrete për iniciativa të zhvillimit të qëndrueshëm rural.*

*Ne u bëjmë thirrje të gjithë palëve të interesit që të bashkohen me ne në këtë përpjekje të qëndrueshme të advokacisë rurale dhe të marrin pjesë aktive në këtë platformë dialogu, rrjetëzimi dhe advokacie. Përmirësimi i cilësisë së jetesës në komunitetet rurale është e vetmja alternativë për ta bërë fshatin shqiptar tërheqës për të jetuar, punuar dhe ndërtuar të ardhmen.*

**Jeta buron nga fshati!**

## VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I EVENTIT DHE MOMENTET KYÇE TË PROGRAMIT

Parlamenti i 3-të Rural Shqiptar përfaqëson një përpjekje bashkëpunuese mes ANRD-së dhe tridhjetë e katër OSHC-ve anëtare të veta, në partneritet me Universitetin Bujqësor të Tiranës. Kjo nismë, e ndërmarrë nga ANRD dhe 34 organizatat anëtare, paraqet një platformë unike në kontekstin e Shqipërisë rurale. Organizatat anëtare të ANRD veprojnë në nivel vendor dhe krijojnë në këtë mënyrë një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet niveleve lokale, rajonale dhe kombëtare. Shtrirja e tyre e madhe gjeografike mbulon gjithë vendin, duke ofruar akses të jashtëzënë komunitetet lokale.

Partneriteti mes UBT-së dhe ANRD-së në organizimin e Parlamentit të tretë Rural Shqiptar ndihmon në kapërcimin e hendekut ndërmjet kërkimit dhe praktikës. Kombinimi i stafit akademik të UBT-së dhe organizatave anëtare të ANRD-së në organizimin e workshopeve tematike (bisedimet rurale) rreth tetë temave kryesore do të miksojnë sfondin teorik dhe kërkimor me shembuj praktikë dhe përvojat lokale.

Ky organizim tre ditor po kthehet në një tubim të rëndësishëm kombëtar, duke bërë bashkë përfaqësuesit nga sektori publikë dhe jopublikë nga 61 bashkitë e vendit, donatorë, akademikë dhe pushteti qendror. Parlamenti rural krijon hapësirë për ndërveprimin e aktorëve relevant të zhvillimit rural për të artikuluar pozicionet dhe rolet e tyre, si dhe sfidat me të cilat përballen për të ushtruar përgjegjësitë dhe ndikimin e tyre. Meqenëse platforma e përgjithshme e PRSH do të fokusohet në **problemet reale evidente në zonat rurale në të gjithë Shqipërinë**, Parlamenti do të kërkojë zgjidhje të mundshme dhe praktike për sfidat e fermerëve dhe banorëve ruralë dhe në fund **do të ofrojë një sërë rekomandimesh për politikat** në mënyrë që të adresojnë prioritetet e zhvillimit të këtyre zonave.

Platforma e parlamentit rural **mbështet fermerët e vegjël dhe fermat familjare duke reflektuar një shqetësim të madh për mirëqenien e ardhshme** të komuniteteve të vogla fermere. Takime të tilla, si parlamenti rural, synojnë gjetjen e zgjidhjeve praktike, të cilat adresojnë këto shqetësime, duke përfshirë rolin e kooperativave, diversifikimin e fermave dhe ekonomive të vogla rurale, menaxhimin e kullotave, investimet në infrastrukturë, mbështetjen për fermerët e rinj, barazinë gjinore etj. Ndërkohë që njihet dhe vlerësohet kontributi i fermerëve të mëdhenj në ekonominë e vendit, shqetësimi për mirëqenien e fermerëve të vegjël është i drejtë dhe aktual. Sfidat dhe kufizimet që ndikojnë negativisht në zhvillimin rural të Shqipërisë dhe në veçanti komunitetet e vogla fermere, do të identifikohen në sesionet e bisedave rurale. Deklarata e Përbashkët e Parlamentit të tretë Rural Shqiptar do të pasqyrojë shqetësime të tilla dhe do të advokojë për mirëqenien e fermerëve të vegjël.

Platforma e Parlamentit të 3-të Rural Shqiptar fokusohet **në realitetin e të rinjve në zonat rurale mes sfidave dhe aspiratave të tyre për të ardhmen**. Nisur nga roli i tyre dhe kontributi i rëndësishëm në qëndrueshmërinë e jetës komunitare në zonat rurale, në bujqësi dhe sigurinë ushqimore, migrimi i



tyre është një nga sfidat më të mëdha dhe rreziku kryesor i qëndrueshmërisë të sektorit. Politikat publike ekzistuese kanë qenë joefektive në adresimin e çështjeve që lidhen me përfshirjen e të rinjve në bujqësi, si dhe trendin gjithnjë në rritje të migrimit të tyre.

Në vitin 2019, ANRD lançoi Qendrën e Rinisë Rurale, duke përfshirë të rinj nga zonat rurale, studentë, sipërmarrës, fermerë, të cilët janë entuziastë dhe të motivuar për të luajtur një rol aktiv dhe kontribuar në proceset dhe vendimmarrjen e zhvillimit rural. Ky grup rinor përforcon zërin e të rinjve nga Shqipëria rurale dhe ndikon në vendimmarrjen rurale, për t'i bërë këto procese të orientuara nga të rinjtë dhe të lidhura ngushtë me nevojat dhe interesat e tyre. Programi i tretë i PRSH-së prezanton një aspekt të ri: për herë të parë të rinj nga zonat rurale, fermerë, sipërmarrës, studentë etj mblidhen në Asamblenë e tyre rinore: me të rinjtë, për të rinjtë, nga vetë të rinjtë e Qendrës Rinore Rurale të ANRD”.

**Fuqizimi i grave dhe vajzave në zonat rurale** ka qenë në qendër të advokacisë nga poshtë-lart të inicuar nga ANRD për të avancuar interesat dhe prioritetet e grave në mënyrë për të siguruar mbështetje publike për mundësi më të mëdha sociale dhe ekonomike. Gratë në zonat rurale janë aktore të rëndësishme në sektorin agro-ushqimor dhe kontribueset kryesore në bujqësi dhe zhvillim rural. Megjithatë, sektori nuk i ndihmon gratë rurale të përmirësojnë statusin e tyre social ekonomik për shkak të vështirësive dhe sfidave që ato përjetojnë. Këto sfida vështirësojnë dhe minimizojnë produktivitetin dhe potencialin sipërmarrës të grave duke sjellë përfitime të pabarabarta për burrat dhe gratë në zinxhirët e vlerës në sektorin agro-ushqimor.

Për të pestin vit rradhazi (2023), me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Grave Rural, edicioni i vitit 2023 i 'ProGrave Rurale' do të bëjë bashkë gra dhe vajza rurale për të diskutuar shqetësimet, prioritetet si dhe veprimet konkrete që duhen inkurajuar dhe ndërmarrë nga institucionet për të përmirësuar mirëqenien e grave dhe vajzave në zonat rurale. ANRD, organizatat e veta anëtare dhe partnerët kujdesen për mirëqenien e grave dhe vajzave në zonat rurale. Në këtë mënyrë, ANRD do përpiqet të bëjë përpjekje të qëndrueshme advokacie për të njohur rolin dhe kontributin e paçmuar të grave në bujqësi dhe zhvillim rural, për të ndërtuar solidaritet mbarëshoqëror për fuqizimin e grave dhe vajzave në zonat rurale.

ANRD luan një rol të rëndësishëm si organizata **partnere kombëtare e Parlamentit Rural Evropian dhe Parlamentit Rural Ballkanik** - dy fushata pan-evropiane që përforcojnë zërin e Evropës rurale. Përfshirja e ANRD-së në këto nisma rajonale dhe evropiane krijon sinergji të jashtëzakonshme. Përfaqësuesit e ANRD marrin pjesë aktive në dy parlamentet rurale, Parlamentin Rural Evropian dhe Ballkanik, në rolin e folësit kryesor dhe si pjesëmarrës aktivë. Këto platforma unike i mundësojnë ANRD jo vetëm për të angazhuar një audiencë më të gjerë, por edhe për të përkrahur konceptin e parlamenteve rurale, duke përforcuar rolin e tyre si instrumente të rëndësishme për zhvillimin rural.

Parlamenti i 3-të Rural Shqiptar parashikon **seanca plenare, biseda rurale, diskutime, folës kryesorë, etj.** Ai shërben si një platformë vendimtare për politikëbërësit, institucionet publike dhe private, organizatat e shoqërisë civile, komunitetin e donatorëve, akademinë dhe të tjerët për të vlerësuar progresin e vazhdueshëm dhe promovimin e ndryshimeve në politika dhe praktika për të siguruar zhvillimin e "Agjendës Rurale Shqiptare". Kjo realizohet nëpërmjet një qasjeje gjithëpërfshirëse që përfshin të gjithë banorët ruralë, duke nxitur pjesëmarrjen e tyre në formësimin e këtij procesi transformues.

### **Asambleja e Parë Kombëtare e të Rinjve në Zonat Rurale: E tashmja dhe e ardhmja e të rinjve në zonat rurale.**

Asambleja Kombëtare e parë e të rinjve në zonat rurale shënon një ngjarje të rëndësishme që ka në qendër perspektivat e tashme dhe të ardhme të rinisë rurale. Në kuadër të Parlamentit të 3-të Rural Shqiptar, Asambleja hedh dritë mbi realitetet me të cilat përballen të rinjtë në zonat rurale, si sfidat ashtu edhe aspiratat që ndikojnë në jetën e tyre. Duke njohur rolin themelor të të rinjve në mbështetjen e komuniteteve rurale, bujqësisë dhe sigurisë ushqimore, Asambleja vendos në qendër të vëmendjes një çështje urgjente: migrimin e të rinjve nga zonat rurale, i cili paraqet riskun më të rëndësishëm për qëndrueshmërinë e sektorit.

Programi i 3-të i PRSH-së krijon një mundësi të parë: krijimin e një Asambleje Rinore, e cila funksionon "me të rinjtë, për të rinjtë, nga vetë të rinjtë" nën drejtimin e Qendrës së Rinisë Rurale. Asambleja ofron një forum të dedikuar për të adresuar shqetësimet, perspektivat dhe aspiratat unike të të rinjve të zonave rurale.

### **EDICIONI I 5 I PRO GRAVE RURALE: Gratë rurale kultivojnë ushqim cilësor për të gjithë.**

Për të pestin vit radhazi, edicioni i vitit 2023 i "Pro-Grave Rurale" përkon me Ditën Ndërkombëtare të Grave Rurale. Ky event shërben si një platformë për të bërë bashkë gratë dhe vajzat e komuniteteve rurale për t'u përfshirë në diskutime rreth shqetësimeve të tyre, prioritetëve dhe hapave që institucionet duhet të ndërmarrin. ANRD, organizatat anëtare dhe partnerët e saj, mbeten të përkushtuar për të advokuar për mirëqenien e grave dhe vajzave në zonat rurale. Kjo përpjekje e qëndrueshme advokuese njeh rolin dhe kontributet e rëndësishme të grave në bujqësi dhe zhvillimin rural, ndërsa nxit solidaritetin mbarëshoqëror për fuqizimin e grave dhe vajzave në zonat rurale.

Ky tubim i grave dhe vajzave të zonave rurale, një traditë e përvitshme e ANRD-së, zhvillohet në ditën e dytë të PRSH të tretë, duke festuar Ditën Ndërkombëtare të Gruas Rurale. Energjia e Asamblesë së të Rinjve dhe fuqizimi i grave rurale e kthejnë PRSH në një ngjarje gjithëpërfshirëse.

**PREZANTIMI I DY ÇMIMEVE NË ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM RURAL** – një nismë që i kushtohet nderimit të trashëgimisë së jashtëzakonshme të dy profesionistëve që kryesuan zhvillimin e qëndrueshëm rural në Shqipëri.

ANRD synon të krijojë një trashëgimi që nxit zhvillimin dhe progresin e vazhdueshëm të komuniteteve rurale shqiptare, duke vlerësuar udhëheqësit/

liderët dhe duke krijuar një rrjet të personave që sjellin ndryshimin dhe më tej përforcojnë përpjekjet e tyre në nivel kombëtar dhe lokal.

### FESTIMI I JETËS DHE KULTURËS RURALE SHQIPTARE DHE DIALOG për të nxitur një lidhje më të thellë me zemrën rurale të Shqipërisë.

Programi PRSH-së ofron një platformë gjithëpërfshirëse për të festuar kolektivisht jetën dhe kulturën rurale, duke ofruar një sërë aktivitesh tërheqëse si: panair, kinema të hapur, ekspozitë fotografie dhe demonstrime. Programi ofron një ftesë të hapur për të gjithë pjesëmarrësit, duke i ftuar ata të marrin pjesë në këtë aktivitet festiv të pasurisë dhe diversitetit të komuniteteve rurale shqiptare.

Ushqimet lokale, të përgatitura mjeshtërisht nga gratë pjesëmarrëse të edicionit të 5-të të Pro-Grave Rurale do të ekspozojnë produktet e territorit të Shqipërisë rurale.

Kinemaja e hapur fton entuziastët për të ndarë njohuritë e tyre, duke nxitur një dialog të hapur mes pjesëmarrësve ndërsa përfshihen në diskutime pas shfaqjes së dokumentarëve. Ndërkohë, ekspozita e fotografisë "Shqipëria Rurale" i çon pjesëmarrësit në një udhëtim vizual përmes shkrepjeve për të kapur thelbin e jetës rurale në Shqipëri. Në një kënd tjetër programi plotëson dhe më tej përvojën duke ftuar pjesëmarrësit të përfshihen në sesione degustimi, ku mund të provojnë dhe vëzhgojnë përgatitjen artizanale të produkteve vendase. Disa nga gratë dhe vajzat pjesëmarrëse do të veshin me krenari xhubletën dhe kostume tradicionale të ndryshme lokale, duke prezantuar trashëgiminë shumëngjyrëshe të zonave rurale.

Këto elemente bashkohen për të dhënë një festë të jetës dhe kulturës rurale dhe një mundësi për të nxitur lidhjet dhe mirëkuptimin midis pjesëmarrësve.

### SESIONI PËRFUNDIMTAR: SINTEZA DHE MESAZHET KRYESORE

Sesioni përmbyllës synon të paraqesë një sintezë të thellë të diskutimeve dhe njohurive të ndara përgjatë gjithë PRSH-së:

- Prezantimet dhe përfundimet nga grupet tematike, Asambleja e të rinjve dhe Pro-Grave Rurale do të jenë në fokus të sesionit. Këto konkluzione përfaqësojnë njohuritë e përbashkëta të zërave të ndryshëm të mbledhur në këtë ngjarje në eksplorimin e çështjeve kritike.
- Sesioni përmbyllës na prezanton me mesazhet kryesore të përfaqësuesve të lartë të qeverisë dhe përfaqësuesve të tjerë të rëndësishëm, të cilët do të ndajnë mesazhet e tyre për të ardhmen, duke përfshirë edhe rekomandimet që dolën gjatë këtij takimit gjithëpërfshirës,

Ky sesion përmbyllet frymën e bashkëpunimit, rrjetëzimit dhe ndërtimit të partneritetit që përkufizon vetë PRSH, duke ofruar një perspektivë të përbashkët për rrugën e ardhshme.

**DEKLARATA E PËRBASHKËT** e Parlamentit të tretë Rural Shqiptar përfshin vizionin për komunitetet rurale dhe një sërë rekomandimesh që synojnë adresimin e prioriteteve për zhvillimin e komuniteteve rurale në Shqipëri.

PROGRAMI

*Jeta buro  
nga fshati!*

PARLAMENTI I TRETË RURAL SHQIPTAR,  
11-13 TETOR 2023



VENDI: **UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS, GODINA A, KATI I I-RË, SALLA "BEHAR MALE"**

**9:30 – 10:00:** Regjistrimi i pjesëmarrësve  
**10:00:** Çelja e Parlamentit të Tretë Rural Shqiptar

09:00 – 10:00



### Mirëseardhja

Fjalë përshëndetëse nga organizatorët

- **Zj. Evelina Azizaj**, Koordinatore Kombëtare, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural
- **Z. Fatbardh Sallaku**, Rektor i Universitetit Bujqësor të Tiranës

Fjalë përshëndetëse nga përfaqësuesit institucional

- **Zj. Anila Denaj**, Ministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (tbc)
- **Z. Boban Ilic**, Sekretar i Përgjithshëm, Grupi i Përhershëm i Punës për Zhvillimin Rural Rajonal në Europën Juglindore (tbc)

Fjalë përshëndetëse nga të ftuarit

- **Z. Kim Smedslund**, Anëtar i grupit drejtues të Parlamentit Rural Evropian
- **Zj. Karin Rau**, Menaxhere Projekti, përfaqësuese e GIZ, Maqedoni e Veriut

10:30 - 12:00



### SESIONI PLENAR

#### Realitete rurale shqiptare mes sfidave dhe mundësive për zhvillim

Parlamenti i Tretë Rural Shqiptar fillon me një seancë plenare gjithëpërfshirëse me përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, donatorë dhe komuniteti ndërkombëtar, OSHC, fermerë dhe banorë ruralë etj. Objektivi i sesionit është të vendosë kuadrin kontekstual për diskursin e mëtejshëm në lidhje me Shqipërinë rurale. Diskutimi trajton mundësitë dhe sfidat, duke orientuar dialogun që do mbahet gjatë parlamentit.

**Moderator: Mr. Renaldo Salianji, Gazetar**

- Përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (tbc)
- **Zj. Aulona Veizi**, N/Kryetare e Bashkisë Vlorë
- **Z. Fatbardh Sallaku**, Rektor i Universitetit Bujqësor të Tiranës
- **Z. Sotiraq Hroni**, Kryetar Bordi, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural
- **Z. Arben Shkodra** – Sekretar i Përgjithshëm, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptar
- **Zj. Marjana Koçeku**, Sipërmarrëse, “Neomalsore”

**Zërat Lokalë: Tre ndërhyrje nga komunitetet rurale**

*Debati plenar do të bazohet në raste të jetës së vërtetë nga realiteti aktual rural. Këto raste përshkruese do të prezantohen nga pjesëmarrësit e Parlamentit Rural Shqiptar, që përfaqësojnë role të ndryshme në zhvillimin rural. Secili nga rastet e prezantuara do të nxjerrë në pah një rast specifik, një skenar autentik rural që përjetohet nga një komunitet i caktuar. Këto raste, megjithëse të lokalizuara, përfaqësojnë shqetësime të rëndësishme për komunitetet më të gjera në të gjithë Shqipërinë rurale. Panelistët do të reagojnë ndaj këtyre ndërhyrjeve të shkurtra duke ofruar këndvështrime sipas perspectives institucionale që ata përfaqësojnë, dhe zgjidhje konkrete për të adresuar këto sfida në të ardhmen.*

12:00 – 12:20

**Folësi kryesor: Mr. Hartmut Berndt, Shoqata Gjermane LEADER**

**Rëndësia e qasjes LEADER dhe domosdoshmëria e prioritizimit të këtij instrumenti për Shqipërinë**  
**Z. Hartmut Berndt** është Kryetar i Shoqatës Gjermane LEADER dhe Zëvendës President i ELARD (Shoqata Evropiane LEADER për Zhvillimin Rural). Me një përvojë prej dy dekadash si menaxher i GVV-së në Göttingen, një rajon malor qendror në Gjermani, z. Berndt ka kontribuar aktivisht në zhvillimin rural. Si kryetar i Shoqatës Gjermane LEADER, z. Berndt është anëtar i bordeve kombëtare dhe Evropiane dhe i këshillit qeveritar të ekspertëve për zhvillimin rural.

12:30 – 12:45



**Prezantimi i çmimit “Pier Paolo Ambrosi” për lidership në zhvillimin rural** - një nismë që i kushtohet nderimit të trashëgimisë së jashtëzakonshme të Pier Paolo Ambrosio që kryesoi zhvillimin e qëndrueshëm rural në Shqipëri.

*Çmimi do të nderojë kujtimin e kolegut tonë të dashur, Pier Paolo Ambrosi duke njohur dhe vlerësuar aktorët lokalë, të cilët tregojnë lidership dhe kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve rurale në të gjithë Shqipërinë. Çmimi do të promovohet bashkarisht me VIS Albania çdo dy vjet, me rastin e Parlamentit Rural Shqiptar.*

Nisma synon të krijojë një trashëgimi që nxit zhvillimin dhe progresin e vazhdueshëm të komuniteteve rurale shqiptare, duke vlerësuar udhëheqësit/ liderët në zhvillimin e qëndrueshëm rural dhe të krijojë një rrjet të personave që sjellin ndryshimin dhe më tej përforcojnë përpjekjet e tyre në nivel kombëtar dhe lokal.

12:45 – 13:00



#### KONFERENCË PËR SHTYP

*Një konferencë e shkurtër për shtyp për të informuar gjerësisht publikun për këtë tubim të rëndësishëm për bujqësinë dhe zhvillimin rural*

- **Zj. Evelina Azizaj**, Koordinatore Kombëtare, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural
- **Prof. Dr. Erinda Lika**, Zv. Rektor, Universiteti Bujqësor i Tiranës
- **Përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (tbc)**

12:45 – 14:30



**Pushim dreke dhe rrjetëzim informal**  
Vendi: Hapësira e jashtme përballë Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit

**Asambleja e Parë Kombëtare e të Rinjve në Zonat Rurale:** E tashmja dhe e ardhmja e të rinjve në zonat rurale

*Programi i 3-të i PRSH-së krijon një mundësi për herë të parë: krijimin e Asamblesë Rinore, e cila funksionon “me të rinjtë, për të rinjtë, nga vetë të rinjtë” nën drejtimin e Qendrës së Rinisë Rurale, së ANRD-së. Asambleja ofron një forum të dedikuar për të adresuar shqetësimet, perspektivat dhe aspiratat unike të të rinjve të zonave rurale (shih programin më poshtë)*

14:30 – 17:45



**DISKUTIME RURALE: Sfidat, prioritetet dhe zgjidhjet për zhvillimin e qëndrueshëm rura** (shih programin më poshtë)



# ASAMBLEJA E PARË KOMBËTARE E TË RINJVE NË ZONAT RURALE

**“Me të rinjtë,  
për të rinjtë,  
nga vetë të rinjtë”**

11 Tetor 2023





14:30 – 17:45

**ASAMBLEJA E PARË KOMBËTARE E TË RINJVE NË ZONAT RURALE**

Vendi: Universiteti Bujqësor i Tiranës, Godina A, kati i I-rë, Salla “Behar Male”

*Asambleja e parë Kombëtare e të rinjve në zonat rurale shënon një ngjarje të rëndësishme që ka në qendër perspektivat e tashme dhe të ardhme të rinisë rurale. Në kuadër të Parlamentit të 3-të Rural Shqiptar, Asambleja hedh dritë mbi realitetet me të cilat përballen të rinjtë në zonat rurale, si sfidat ashtu edhe aspiratat që ndikojnë në jetën e tyre. Duke njohur rolin themelor të të rinjve në mbështetjen e komuniteteve rurale, bujqësisë dhe sigurisë ushqimore, Asambleja vendos në qendër të vëmendjes një çështje urgjente: migrimin e të rinjve nga zonat rurale, i cili paraqet edhe riskun më të rëndësishëm për qëndrueshmërinë e sektorit dhe jetës komunitare në zonat rurale.*

14:30 – 15:00

**HAPJA E SESIONIT**

Moderatore: **Ms Rashela Shehu**, Gazetare

**Mirëseardhja dhe Prezantimi i programit për të rinjtë****Fjalët përshëndetëse:**

- **Zj. Martina Dedaj**, Kryetare Bordi, Qendra e Rinisë Rurale
- **Prof. Asoc. Dritan Laçi**, Koordinator, Qendra e Karrierës dhe Alumni, Universiteti Bujqësor i Tiranës
- **Zj. Bora Muzhaqi**, Ministër Shteti për Rininë dhe Fëmijët (tbc)
- **Zj. Valerie Covic**, Menaxhere Programi, Delegacioni i Bashkimit evropian në Shqipëri (tbc)
- **Z. Neil Evans**, Kryetar i Rinisë Rurale Europë (online)

*Sesion energjizues për të rinjtë.*

15:00 – 15:30

**Sesion plenar: E tashmja dhe e ardhmja e të rinjve në zonat rurale**

*Sesioni plenar synon të sjellë së bashku pjesëmarrës të rinj nga zona të ndryshme rurale nga e gjithë Shqipëria për t'u përfshirë në diskutime produktive rreth sfidave me të cilat përballen të rinjtë në këto zona dhe të eksplorojnë perspektivat e tyre në të ardhmen.*

### Folës kryesor:

- **Z. Matteo Bartolini**, Nënkryetar Kombëtar, Konfederata e Fermerëve Italianë: Perspektiva të qëndrueshme në komunitetet lokale për të rinjtë
- **Z. Alqi Kushi**, Drejtor i Përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Rinisë
- **Zj. Evelina Azizaj**, Kërkuese Kombëtare: Raport për Shqipërinë, Prezantimi i gjetjeve të studimit rajonal mbi rolin e të rinjve në zonat rurale, realizuar nga SWG, me mbështetjen e FAO-se dhe Ministrisë së Ushqimit dhe Bujqësisë të Gjermanisë.
- **Z. Benito Prendi**, RTM: Projekti i rinisë shqiptare rurale dhe ndikimi i tij në angazhimin e të rinjve në bujqësi dhe zhvillim rural
- **Z. Julvin Marku**, Sipërmarrës i ri

15:30 – 16:30



**Ndërveprime nga të rinjtë:** Komente/pyetje dhe perspektiva

*Një mundësi për pjesëmarrësit e rinj që të shkëmbejnë mendimet e tyre dhe të përfshihen në diskutim.*

16:30 – 17:45



**Dialogu i Rinisë Rurale: Sfida, prioritete dhe zgjidhje** (metodologjia World Caffe)

*Eksplorimi i mundësive për përfshirjen e të rinjve në bujqësi dhe zhvillim rural duke zhvilluar diskutime mbi tema të ndryshme që lidhen me të tashmen dhe të ardhmen e të rinjve në zonat rurale. Këto sesione do të zhvillohen në një ambient në stilin e kafenesë për të nxitur dialogun e hapur dhe shkëmbimin e ideve.*

14:30 – 17:45



**DISKUTIME NË KAFE RURALE: SFIDAT, PRIORITETET DHE ZGJIDHJET PËR ZHVILLIM RURAL TË QËNDRUESHËM**

Vendi: Universiteti Bujqësor i Tiranës, Godina B, kat i 3-të, Salla: 303-309

*Diskutimet paralele në grupe të vogla do t'u mundësojnë pjesëmarrësve të përfshihen në tema të ndryshme me interes dhe të nxisin biseda kuptimplote në lidhje me tema të ndryshme të zhvillimit të qëndrueshëm rural*

15:45 - 16:30



**PUSHIM KAFEJE**

Vendi: Hapësira e jashtme përballë Godinës A

**8 workshope paralele në secilin round::****Roundi i parë: 14:30 - 15:45****Roundi i dytë: 16:30 - 17:45**

**DISKUTIME RURALE** - tetë diskutime në grupe të vogla të organizuara me metodologjinë dinamike të World Café eksplorojnë tetë temat kryesore si më poshtë:

**GRUPI I PUNËS 1: QASJA LEADER MES SHPRESAVE DHE LODHJES SË QYTETARËVE.****Vendi: Godina B, Salla 303**

- Moderatore Prof. Dr. Etleva Dashi, Universiteti Bujqësor i Tiranës
- Folës kryesorë: **Z. Julian Elezi, Pro Përmet; Zj. Anna Carboni, VIS Albania**

**GRUPI I PUNËS 2: BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL NË KONTEKSTIN E SFIDAVE TË NDRYSHIMEVE KLIMATIKE DHE MENAXHIMIT TË QËNDRUESHËM TË BURIMEVE NATYRORE (AGROEKOLOGJI, BLEGTORI E EKSTENSIVE ETJ.)****Vendi: Godina B, Salla 304**

- Moderatore: Prof. Dr. Erinda Lika, Universiteti Bujqësor i Tiranës
- Folës kryesorë: **Zj. Stella Beghini & Zj. Rozeta Gradeci, përfaqësuese nga COSPE Onlus**

**GRUPI I PUNËS 3: FERMERËT E VEGJËL DHE POZICIONI I TYRE NË ZINXHIRËT E VLERËS****Vendi: Godina B, Salla 305**

- Moderator: Prof. Dr. Ilir Kapaj, Universiteti Bujqësor i Tiranës
- Folës Kryesor: **Z. Shpëtim Cura, World Vision Albania**

**GRUPI I PUNËS 4: RUAJTJA E KULTURËS TRADICIONALE DHE NXITJA E MIRËQËNIES SË KOMUNITETEVE BARITORE****Vendi: Godina B, Salla 306**

- Moderator: Prof. Asoc. Dr. Romina Koto, Universiteti Bujqësor i Tiranës
- Folës Kryesorë: **Z. Olivier Maurin, Bashkëdrejtues i Grupit Evropian në mbështetje të Vitit Ndërkombëtar të Kullotave dhe Pastoralistëve; Përfaqësues nga Shoqata "Shtëpia e Barinjve"**

**GRUPI I PUNËS 5: AGROTURIZMI DHE NDËRLIDHJA E TIJ ME SFIDAT E BUJQËSISË, BLEGTORISË DHE SEKTORËVE TË TJERË****Vendi: Godina B, Salla 307**

- Moderator: Prof. Asoc. Dr. Shpresim Domi, Universiteti Bujqësor i Tiranës
- Folës kryesor: **Z. Petrit Dobi, Drejtor Ekzekutiv, Programi Mbështetjes së Shoqatave Rurale (RASP)**

**GRUPI I PUNËS 6: NXITJA E NJOHURIVE, KAPACITETEVE DHE KOMPETENCAVE PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM; (ROLI I NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE, ORGANIZATAVE LOKALE, INSTITUCIONEVE KËRKIMORE DHE AKADEMIKE)**

Vendi: Godina B, Salla 308

- Moderator: Prof. Asoc. Dr. Fatmir Guri, Universiteti Bujqësor i Tiranës
- Folës kryesorë: Z. Tomi Pikuli, Drejtor Ekzekutiv, AGRINET; Z. Enver Isufi, Drejtor Ekzekutiv, Instituti i Bujqësisë Biologjike

**GRUPI I PUNËS 7: SHTJELLIMI I PROGRAMIT “100 FSHATRA”: MËSIMET E NXJERRA PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM RURAL**

Vendi: Godina B, Salla 309

- Moderator: Prof. Dr. Remzi Keco, Universiteti Bujqësor i Tiranës
- Folës kryesor: Përfaqësues nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit

**GRUPI I PUNËS 8:ROLI I GRAVE NË SEKTORIN AGROUSHQIMOR DHE ZINXHIRËT E VLERAVE TË NDJESHME GJINORE**

Vendi: Godina B, Salla 312

- Moderatore: Prof. Dr. Tatjana Dishnica, Universiteti Bujqësor i Tiranës
- Folës Kryesor: Z. Sabah Djaloshi, Drejtor Ekzekutiv, AgroPuka

Metodologjia e “World Café” mundëson eksplorimin e një teme nga këndvështrime të shumta dhe i jep mundësinë të gjithëve të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në një bisedë.

*“Biseda është në qendër të marrjes së informacionit dhe të njohurive. Bisedimi është ndoshta aftësia më thelbësore njerëzore për t’u përballur me sfidat e jashtëzakonshme me të cilat ndeshemi. Për t’u përfshirë në një qytetërim të madh, duhet të bëjmë pyetje që kanë rëndësi. Nuk mund të përballojmë të shpenzojmë kohën tonë për çështje që nuk janë në vëmendjen tonë, që nuk na prekin zemrat. Kultura e bisedës është një kulturë tjetër, që mund të sjellë ndryshim në të ardhmen e botës sonë”.*



DITA 2  
12 TETOR  
2023

## EDICIONI I 5 PRO-GRUAS RURALE: Gratë rurale kultivojnë ushqim cilësor për të gjithë

Vendi: Universiteti Bujqësor i Tiranës,  
Godina A, kati i I-rë, Salla "Behar Male"

*Për të pestin vit radhazi, edicioni i vitit 2023 i "Pro-Gruas Rurale" përkon me Ditën Ndërkombëtare të Gruas Rurale. Ky event shërben si një platformë për të bërë bashkë gratë dhe vajzat e komuniteteve rurale për t'u përfshirë në diskutime rreth shqetësimeve të tyre, prioriteteve dhe hapave që institucionet duhet të ndërmarrin. ANRD, organizatat e veta anëtare dhe partnerët, mbeten të përkushtuar për të advokuar për mirëqenien e grave dhe vajzave në zonat rurale. Kjo përpjekje e qëndrueshme advokacie njih rolin dhe kontributet e rëndësishme të grave në bujqësi dhe zhvillimin rural, ndërsa nxit solidaritetin mbarëshoqëror për fuqizimin e grave dhe vajzave në zonat rurale.*

10:00 – 10:15



### Mirëseardhja dhe prezantimi i programit

- **Zj. Evelina Azizaj**, Koordinatore Kombëtare, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural
- **Zj. Albana Koçiu**, Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (tbc)
- **Zj. Stefania Vizzaccaro**, Drejtore, Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillimi
- **Z. Deni Guga**, Përfaqësues UN Women, Shqipëri

10:15 – 11:45



### Sesion plenar: Sfidat dhe nevojat e grave të angazhuara në sektorin agri-ushqimor

- Moderatore: **Zj. Erisa Kryeziu**, Gazetare
- **Zj. Etleva Sheshi**, Drejtore e Politikave të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- **Zj. Tatjana Dishnica**, Drejtore Ekzekutive, Gratë në Bujqësinë e Qëndrueshme
- **Z. Edvin Zhllima**, Kërkues Kombëtar: Raporti për Shqipërinë: Prezantimi i studimit rajonal mbi rolin e grave rurale në zonat rurale, i realizuar nga SWG me mbështetjen e BMZ përmes GIZ, nga BMEL.
- **Zj. Selvije Lufo**, Sipërmarrëse, Njësia Administrative Velçan, Pogradec

11:45 - 12:00



**Prezantimi i çmimit "Liljana Isakaj", për Fuqizimin e Grave Rurale** është një nismë kushtuar nderimit të trashëgimisë së jashtëzakonshme të Liljana Isakajt, e cila ia kushtoi jetën zhvillimit rural dhe fuqizimit ekonomik të grave rurale. Si epitome e grave rurale, Liljana hapi rrugën për progres, lidhësi dhe ndryshim pozitiv në komunitetet rurale. Ky çmim do të vlerësojë individë që kanë kryer përpjekje të jashtëzakonshme për të përmirësuar jetën e grave rurale. Çmimi do të promovohet së bashku me "ADAD malore", çdo vit me rastin e organizimit të ProGraveRurale.

Kjo nismë synon të krijojë një trashëgimi që nxit zhvillimin dhe progresin e vazhdueshëm të komuniteteve rurale shqiptare, duke vlerësuar udhëheqësit/ liderët në zhvillimin e qëndrueshëm rural të krijojë një rrjet të personave që sjellin ndryshimin dhe më tej përforcojnë përpjekjet e tyre në nivel kombëtar dhe lokal

12:00 - 13:45



**Pushim dreke dhe rrjetëzim informal**  
**Vendi: hapësira e jashtme, përballë Godinës B – Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit**

13:45 - 16:30



**Panairi "Shije fshati" i produkteve lokale të prodhura nga gratë pjesëmarrëse të Edicionit të pestë të Pro-Grave Rurale**

*Të festojmë diversitetin dhe pasurinë e zonave rurale shqiptare përmes ushqimeve dhe produkteve lokale, kostumeve dhe muzikës popullore.*

15:00 - 16:30



### **KINEMA E HAPUR**

*Shfaqja e dy dokumentarëve/filmave që trajtojnë tematikat e Parlamentit: efektet e ndryshimeve klimatike në bujqësi; shpopullimi rural dhe migrimi i të rinjve; varfëria dhe përjashtimi social; keqmenaxhimi i burimeve natyrore; infrastruktura e dobët, pastoralizëm ekstensiv, kultura lokale etj*  
 Diskutime dhe shkëmbime: Moderatori jep mendime/opinionet mbi dokumentarin dhe tematikën ndjekur nga një diskutim i hapur me pjesëmarrësit.

### **AKTIVITETE SHITESË:**

Ekspozita e fotografisë "Shqipëria rurale"  
 Degustime dhe demonstrime: produkte lokale dhe prodhimi artizanal i tyre



## SESIONI PËRFUNDIMTAR: SINTEZA DHE MESAZHET KRYESORE

Vendi: Universiteti Bujqësor i Tiranës,  
Godina A, kati i I-rë, Salla "Behar Male"

*Ky sesion përmbledh frymën e bashkëpunimit, rrjetëzimit dhe ndërtimit të partneritetit që përkufizon vetë PRSH, duke ofruar një perspektivë të përbashkët për rrugën e ardhshme. Sesioni përmbyllës synon të paraqesë një sintezë të diskutimeve dhe njohurive të ndara përgjatë PRSH. Ky sesion shpalos mesazhet kryesore nga përfaqësues të qeverisë së nivelit të lartë dhe përfaqësues të tjerë të shquar, të cilët do të ndajnë mesazhet e tyre largpamëse, duke përfshirë pikat kryesore nga ky takim gjithëpërfshirës.*

10:00



### Fjala e hapjes

- **Z. Arben Pëllumbi**, Kryetari i Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit
- **Zj. Evelina Azizaj**, Koordinatore Kombëtare, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural

10:15



### Përfundime dhe rekomandime

*Konkluzionet dhe rekomandimet vijnë nga sesionet e kryesore, grupet tematike, Asambleja e të rinjve dhe Pro-Grave Rurale. Këto konkluzione përfaqësojnë njohuritë e përbashkëta të zërave të ndryshëm të mbledhur në PRSH-në e tretë në eksplorimin e çështjeve kritike në bujqësi dhe zhvillim rural.*

- Përfundime nga grupet tematike "Bisedimet rurale".
- Përfundime nga Asambleja Kombëtare e Rinisë në Zonat Rurale
- Përfundime nga Edicioni i 5-të i Grave Pro-Rurale 2023

10:45



### Mesazhet kyçe nga përfaqësues të lartë të qeverisë

- **Mesazhet kyçe nga përfaqësues të sektorit, të qeverisë dhe donatorët.**
- **Zj. Anila Denaj**, Ministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (tbc)
- **Z. Andrea Ferrero**, Team Leader, Seksioni i Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik dhe Social, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri
- **SHTZ. Edi Rama**, Kryeministër i Shqipërisë (tbc)


### **Hapat e ardhshëm:**

Momenti më i rëndësishëm i Parlamentit të 3-të Rural Shqiptar do të arrihet me përgatitjen e DEKLARATËS SË PËRBASHKËT. Kjo deklaratë përfshin vizionin për komunitetet rurale dhe një grup rekomandimesh që synojnë adresimin e prioritetëve të zhvillimit të komuniteteve rurale në Shqipëri. Dokumenti do të hartohet me kujdes pas përfundimit të PRSH të tretë dhe do të shpërndahet gjerësisht tek aktorët e interesit, duke siguruar angazhimin e tyre për avancimin e mëtejshëm të Agjendës Rurale. Pas Parlamentit të 3-të Rural Shqiptar, ANRD do të angazhohet të shpërndajë rezultatet, dhe produktet e kësaj nisme të rëndësishme advokacie.

Parlamenti i tretë Rural Shqiptar realizohet me mbështetjen financiare të:

- Projekti “Rural-You” mbështetet financiarisht nga Bashkimi Evropian në Shqipëri dhe zbatohet nga Volontari nel Mondo RTM, në partneritet me ADAD Malore, Fondacioni Partneritet për Zhvillim, AgroPuka, Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural - ANRD dhe Agia Giovani Imprenditori Agricoli – Agricoltura è Vita Agriagenzia (Cia - Agricoltori Italiani)
- Projekti “Forcimi i rrjetëzimit në Ballkanin Perëndimor për zhvillimin socio-ekonomik të komuniteteve rurale” më mbështetjen financiare të GIZ Maqedonia e Veriut përmes programit SEDRA II (Mbështetje për diversifikimin ekonomik të zonave rurale në Evropën Juglindore).
- Ndërhyrja “Mbështetja e fuqizimit ekonomik dhe social të grave rurale në bashkitë Elbasan dhe Kolonjë” i cili po zbatohet nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural në kuadër të projektit “Fuqizimi i Grave në zonat rurale dhe turizmi” (GREAT), të financuar nga Qeveria Italiane dhe në partneritet me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Shqipërisë.





Realizuar me mbështetjen e:



# Jeta burore nga fshati

## Parlamenti i tretë Rural Shqiptar 2023

11-13 Tetor 2023

Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural (ANRD) është një rrjet i tridhjetë e katër OSHC-ve lokale me profile të konsoliduara në zhvillimin rural dhe i krijuar nga 'poshtë-lart' në vitin 2015 (anrd.al) me synimin për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve rurale në Shqipëri. ANRD është rrjet aktiv në fushën e politikave të zhvillimit rural, për të adresuar nevojën për politikëbërje efektive të zhvillimit rural përmes përfshirjes së drejtpërdrejtë të aktorëve jopublikë në formulimin dhe zbatimin e politikave të sektorit.

ANRD përqipet të advokojë për politika efektive rurale, të cilat janë të lidhura ngushtë me situatën e banorëve të komuniteteve rurale; të hartuara me pjesëmarrjen e komuniteteve rurale, që kuptohen dhe zbatohen nga njerëzit në terren. ANRD dhe organizatat e veta anëtare ndajnë të njëjtin vizion dhe kanë dakortësuar të punojnë së bashku për të avancuar rolin e sektorit privat dhe shoqërisë civile në agjendën kombëtare rurale. Rrjeti ka përkrahur një perspektivë me orientim 'nga poshtë-lart' dhe po zbaton një qasje gjithëpërfshirëse dhe kombëtare për të përmirësuar kapacitetet shoqërore në përgatitjen e vendit drejt përvetësimit të praktikave dhe modeleve që do e integrojnë më tej Shqipërinë në Bashkimin Evropian.

